

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Divizioni për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim

Tema: PËRPILIMI I KËRKESAVE (PYETJEVE) SIPAS
KONCEPTIT TË TAKSONOMISË SË BLOOM –it

Mustafë Kadriu, prof

Qëllimi i temës:

Iformatë për përpilimin e kërkesave në test, bazuar në objektiva të dijes sipas konceptit të Taksonomisë së Bloom, ilustruar me shembuj konkret.

Objektivat udhëzuese:

Objektivat udhëzuese në procesin e mësimdhënies dhe të mësim nxënies paraqesin nivelin e dijës së nxënësve në përvetësim të njohurive dhe shkathtësive.

Objektivat ndahen:

Objektiva të përgjithshme

Objektiva specifike

Çka përfaqësojnë objektivat e përgjithshme ?

- Përfaqësojnë shkathtësitë e fituara nga ana e nxënësit.
- Quhen të përgjithëshme sepse përfshin një fushë të gjerë të rezultateve të të nxënës dhe të arritje të rezultateve për një kohë të gjatë.

Rëndësia e objektivave qëndron në sigurimin e:

- Qëndrimeve dhe vlerave;
- Të nxënit e përhershëm të diturive;
- Shkathtësive analitike
- Shkathtësive për zgjidhjen e problemeve
- Aftësive komunikuese;
- Shkathtësive të të mësuarit për të nxënë;
- Shkathtësive për të menduarit në mënyrë të pavarur;
- Shkathtësive të të nxënit duke punuar.

KOMPONENTET QË DUHET TË VLERËSOHEN

□ Njohuritë

Njohuritë janë tërsitë e informacioneve që zotërohet nga ana e nxënësit.

Ka të bëjnë me:

- terminologjia dhe simbolet,
- përkufizimet e koncepteve,
- faktet,
- metodat

□ Aftësitë

Aftësitë janë fuqia dhe cilësia që zotëron një nxënës për të përmbush një veprim në mënyrë të suksesshëm brenda një afati të caktuar kohore.

Kanë të bëjnë me:

- Identifikim
- Përshkrim
- Formulim
- Arsyetim
- Vërtetim
- Zbatim
- Analizë
- Sintezë
- Hipotezë
- Vlerësim

□ **Shkathësitë dhe shprehjet**

- **Shkathësitë tregojnë mënyrën e të menduarit, të punuarit, të komunikuarit, të lidhjes të cilat nxënësit duhet t'i zotërojnë dhe t'i përdorin në situata të ndryshme.**

Ka të bëjë për të kryer:

- Njehësime
- Matje
- Ndërtime
- Skicime
- Zgjidhje
- Përdorim burimesh
- Përdorim informacionesh
- Përdorim teknologjisë
- Lexim të modeleve numerike
- Lexim të modeleve hapësinore
- Krijim të modeleve numerike
- Krijim të modeleve hapësinore

□ Qëndrimet dhe vlerat

- Qëndrimet dhe vlerat tregojnë mënyrën e sjelljes së nxënësve gjatë kryerjes së veprimtarive në procesin mësimor.

Ka të bëjë me:

- Pjesëmarrje në diskutim
- Bashkpunim
- Kërkim ndihme
- Dhënie ndihme
- Verifikim
- Respektim mendimi i tjetrit/rës
- Marrje e përgjegjësive
- Vëmendje
- Dmonstrim vullneti
- Rrespektim i rregullave
- Përmbushje e detyrave

□ **Përpilimi i objektivave të përgjithshme**

Gjatë përpilimit të objektivave të përgjithshme duhet pasqyruar se cilat janë rezultatet e pritura të nxënies ?

Rezultatet e nxënies më të njohura janë:

- **Njohja**
- **Kuptuarit**
- **Zbatimi**
- **Mendimi kritik:**
 - **Analiza**
 - **Sinteza**
 - **Vlerësimi**

[Taksonomija e Bloom]

Objektiva specifik: është pohim mbi atë se çfarë do të jetë në gjendje të bëjë nxënësi në kushte të caktuara.

është pjesë më e veçanta e objektivës së përgjithshëm (veprimet dhe sjelljet e vëzhgueshme e të vlerësueshme të nxënësve).

Me objektivë specifik vlerësohet arritja për nxënësin.

Kjo përshkruhet nëpërmjet tre elementeve vepruese:

Veprimi: (të përshkruaj një veprimtari të nxënësit e tillë që ajo identifikohet me një sjellje të vëzhgueshme),

Kushti: (të tregoi kushtet në të cilat duhet të çfaqet sjellja e dëshiruar),

Kriteri: (të shënojë se në çfarë niveli duhet të jetë veprimtaria përfundimtare e nxënësit dhe se cilat janë kriteret që shërbejnë për të vlerësuar rezultatin – arritja e nxënësit).
(në planprogramet paraqiten objektivat dhe rezultatet e prituta)

Shembull. Të rumbullaksohet se cili nga numrat e dhënë është numër i thjeshtë:

- A. 9
- B. 11
- C. 15
- D. 21

Aftësia e synuar është: të identifikoj numrin e thjeshtë

Veprimi: të rumbullaksojë të saktë 11 si numër i thjeshtë.

Kushti: nga **katër** numrat e dhënë.

Kriteri: **vetëm një** nga numrat e dhënë është numër i thjeshtë.

Objektivi i përgjithshëm: në mbarim të klasës së nëntë nxënësit **njohin** bashkësitë numerike.

Objektivi specifik: në mbarim të klasës së nëntë nxënësit bëjnë **dallimin** ndërmjet numrave të thjeshtë dhe numrave të përbërë.

Përmbajtja programore: Kategoria: **Algjebër**

Nënkategoria: **Numrat real**

Objekivat specifike:

Çfarë mund të bëhet konkretisht

- Shembull: Çka thotë Teorema e Pitagorës ? (Njohje)
Pse në Kosovë nuk mbillet orizi ? (Të kuptuarit)
Të gjendet lartësia e trekëndëshit në se (Zbatim)
Cili nga punimet e paraqitura është më i sakti ...
(Mend. Kritik)

Shembull. Cila është rradhitja e numrave vijues prej më të voglit deri te më i madhi:

$$\begin{array}{l} \text{A. } 3\frac{7}{12}, 3\frac{2}{3}, 3\frac{3}{4} \\ \text{B. } 3\frac{2}{3}, 3\frac{7}{12}, 3\frac{3}{4} \\ \text{C. } 3\frac{3}{4}, 3\frac{7}{12}, 3\frac{2}{3} \\ \text{D. } 3\frac{2}{3}, 3\frac{3}{4}, 3\frac{7}{12} \end{array}$$

- *Aftësia e synuar është:* **krahasimi** i numrave;
- *Veprimi:* **rradhitë** numrat;
- *Kushti:* **prej** më të voglit **deri** te më i madhi;
- *Kriteri:* vetëm **një nga katër** rradhitjet e mundshme;
- *Objektivi i përgjithshëm:* në mbarim të klasës së nëntë nxënësit **analizojnë** bashkësitë e numrave.
- *Objektivi specifik:* në mbarim të klasës së nëntë nxënësit bëjnë **krahasimin** ndërmjet numrave.

Taksonomia e Bloomit:

Klasifikon nivelet:

1. Njohja
2. Kuptimi
3. Zbatimi
4. Mendimi kritik

Analiza


Sinteza

Vlerësimi

Hierarkia e përpilimit të kërkesave sipas taksonomisë së Bloom – it mundëson krijimin e llojllojshmërisë së kërkesave për të parë më mirë se si kanë mësuar nxënësit dhe sa janë në gjendje të dinë nxënësit, sipas niveleve të ndryshme të dijes.

FUSHA E NIVELIT TË DIJES





I. NJOHJA

**Përfaqëson nivelin më të ulët të rezultateve të të nxënit.
Me njohje kuptojmë aftësinë e të kujtuarit të informatave të
zëna gjatë procesit të nxënies.**

■ Njohja e terminologjisë

Objektivat: fjalori, termet, terminologjia.

■ Njohja e fakteve specifike:

Objektivat: burimet, emrat, datat, ngjarjet, vendet, personat, koha, fenomeni, përkufizimet, referencat, elementet, faktet, informatat.

■ Njohja e metodave dhe procedurave:

Objektivat: përdorimet, procedurat, trajtimet.

■ Njohja e konventave dhe trendeve:

Objektivat: format, konventat, përdorimi, rregullat, mënyrat, simbolet, reprezentimet, stilet, formatet.

■ Njohja e klasifikimeve dhe kategorizimi:

Objektivat: lëmenjtë, llojet, ngjarja, format, rregullimet, klasifikimet, kategoritë, kriteret, bazat, elementet.

■ Njohja e kritereve:

Objektivat: metodat, teknikat, qasja.

■ Njohja e univerzales dhe përgjithësimi:

Objektivat: parimet, përgjithësimet, të dhënat e rëndësishme, ligjet.

■ Njohja e teorisë, strukturës, organizimet dhe formulimet:

Objektivat: teoritë, bazat, strukturat, organizimet, formulimet;

■ Njohja e burimeve të informacioneve;

■ Njohja e koncepteve;

Foljet vepruese:

Defino: konceptet, parimet, ligjet etj.

Shembull: Çka quhët segment.

Shembull: Fjala “ Evolucion” do të thotë:

“ ... ”

Shembull: Ligji i parë i Njutonit thotë:

...

Dallo: Identifiko si të ndarë ose të ndryshëm, ndajë në klasë, ose zgjidh llojin e zakonshëm, etj.

Shembull: Trego disa ngjashmëri ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë?

Identifiko: Trego, prek, rrumbullakëso, shëno, përshtat, tërhiq.

Shembull: Cili nga personat e poshtshënuar është shkrimtar ?

- A. Margareta Theqer
- B. Wolfgang Moxarti
- C. Viktor Hygo
- D. Pablo Pikaso

Përcakto : etiketo, rendit, saktëso, emërto, riprodho, recito, përkufizo, konstato, listo, përsëritë, rrëfe, raporto, skico, mbajë në mend, përshekruaj

Shembull: Përshekruaj një procedurë për matjen e ...

Shembull: Në cilin rast janë renditur drejt numrat sipas madhësisë ?

Klasifiko: Klasifiko grupet në bazë të karakteristikave të përgjithshme, dhe i përcakto në një kategori të veçantë.

Shembull: Cilët janë numrat e thjesht nërmjet numrit 1 dhe 50 ?

Shembull: Shëno zanoret e alfabetit shqip.

Rendit : Rendit sipas rradhës, vendos në vazhdim, rregullo dhe rirregullo.

Shembull: Cili numër vije pas numrit 123456789 ?

- A. 1234567890
- B. 123456790
- C. 212345678
- D. 2123456790

Ndërto: Vizato, bëje, projekto, mblidh, përgatitë, ndërto.

Shembull: Vizato një grafik duke përdorur të dhënat e tabelës

...

Demonstro: krijo procedurë me ose pa shpjegim.

Shembull: Instalo pajisjet për eksperimentin që do ta ...

Shembull: Mot quhet:

A. Gjendja e atmosferës në momentin e vështrimit ose të matjes së elementeve meteorologjike.

B. Gjendja e atmosferës në momentin kur bëhet natë.

C. ...

Shembull: Fjala “Ekumen” ka kuptim:

A. Hapësirë e banuar

B. Hapsirë e pa banuar

C. Ekuador

D. Ekosistem

Shembull: Fjala” Ortek” ka kuptim:

A. Sasi e madhe e borës

B. Sasi e madhe e shiut

C. Bryma

D. Vesa

Shembull: Sa është syprina e sipërfaqes së Tokës ?

A. $5,10 \cdot 10^6 \text{ km}^2$

B. $5,10 \cdot 10^2 \text{ km}^2$

Objektivat:

fjalori,
termet
emërtimet,
referenca,
faktet,
informatat,
burimet,
emrat
datat,
ngjarjet,
vendet,
përparësitë,
fenomenet
përdorimet,
rregullat,
mënyrat,
stilet,
simbolet,

format,
aksionet,
proceset
lëvizjet,
zhvillimet,
trendet,
marrdhëniet,
lëmenjtë,
llojet,
ngjarjet,
klasat,
format,
divizionet,
rregullimet,
kriteret,
bazat,
elementet,

qasja,
procedurat,
trajtimi,
parimet,
ligjet,
ndërlidhjet,
strukturat,
organizimet,
formulimet etj.

II. Të kuptuarit

Është nivel më i lartë i rezultateve të të nxënit. Me këtë kuptojmë aftësinë e nxënësit që të nxë kuptimin e një teme, problemi apo të një situatë të caktuar.

Një informacion është kuptuar nga nxënësi nëse ka aftësi në:

■ Përkthimin e informacioneve:

të përkthesh, të transformosh, të japësh me fjalët tuaja, të ilustrësh, të përgatitësh, të ndërrosh, të rifrazosh, të riformulosh etj.

Objektivat: kuptimet, shembujt, definicionet, prezentimet, fjalët, frazat ;

■ **Interpretimi:** të interpretosh, të rirradhitësh, të riorganizosh, të vizatosh, të shpjegosh, të demonstrososh.

Objektivat: relevanca; marrëdhëniet; aspektet; këndvështrimi; kualifikimet; përfundimet; metodat; teoritë; abstraksionet.

- **Të kuptuarit e fakteve dhe parimeve;**
- **Të kuptuarit e relacionit shkak - efekt;**
- **Dokumente të shkruara, grafike, të dhënat numerike.**
- **Të kuptuarit e elementeve; (unitete konceptuale),**
- **Të kuptuarit e marrëdhënieve; (struktura lineare),**
- **Të kuptuarit e sistemeve; (situatave komplekse),**
- **Të kuptuarit e materialeve;**
- **Të arsyetuarit e metodave dhe procedurave;**

Shembuj:

1. Cila është arsyeja për ...? (arsyetim metoda)
2. Cili është relacioni ndërmjet ...? (shkak efekt);
3. Cili prej këtyre është një shembull i ...? (parim);

Kërkesat e të kuptuarit testojnë nivelin më të lartë se ajo e njohjes por jo e nivelit shumë të lartë të dijes.

Kërkesat e të kuptuarit nga nxënësi marrin dy informacione:

Sa nxënësit ndryshojnë informacionin nga një formë në tjetrën;

Sa nxënësit përshkruajnë lidhjen ndërmjet dy e më shumë ideve.

Shembull:

1. Cili numër **nuk** e ka vendin në bashkësinë e numrave $\{ 1, 2, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 17, 19, 23 \}$?

- A. 5
- B. 7
- C. 9
- D. 17

2. Lartësia fokale e thjerrave :

$$\frac{1}{f} = \frac{1}{a} + \frac{1}{b}$$

(a-largesa e objektivit, b-

largesa e shëmbëllimit) është e barabartë me:

$$\text{A. } f = \frac{a \cdot b}{a + b} \quad \text{B. } f = \frac{a + b}{a \cdot b} \quad \text{C. } f = \frac{2}{a + b} \quad \text{D. } f = \frac{a + b}{2}$$

3. Cila nga shkronjat { b, j, m, p } është bashkëtingëllore hundore ?

A. b

B. j

C. m

D. p.

4. Të shkruhet në thyesë që përshkruan pjesa e hiezuar e figurës:



5. Parisi është në Francë kryeqytet, sikurse që është në Zvicër:

A. Cyrry

B. Berni

C. Bazelli

D. Zheneva

III. Zbatimi:

Është shkalla më e lartë e rezultateve të të nxënit. Me Zbatim kuptojmë aftësitë e nxënësit që të përdorë apo të zbatojë informacionet e njohura në situata të reja të jetës së përditshme.

Përfshin aftësitë e të zbatuarit të:

- Fakteve në situata të reja;**
- Parimeve në situata të reja;**
- Metodave dhe procedurave në situata të reja;**
- Ligjeve dhe teorive në situata të reja;**
- Zgjidhjen e problemeve.**

- Kërkesat e zbatimit zënë një vend të mesëm në nivelin e dijes.
- Kërkesat në zbatim kërkojnë nga nxënësit jo vetëm të mbajnë mend dhe të kuptojnë informacionin e paraqitur por edhe të përdorin ato në zgjidhjen e problemeve.
- Te këto kërkesa e rëndësishme është që të jenë nxitëse e jo shumë të vështira.

Shembull: Radio Kosova emiton radio program në valë të mesme valore $\lambda = 212,3 \text{ m}$. Sa është frekuenca e valëve elektromagnetike të këtij radiostacioni ?

A. $\nu = 1413 \text{ Hz}$ B. $\nu = 141 \text{ Hz}$ C. $\nu = 1314 \text{ Hz}$ D. $\nu = 134 \text{ Hz}$

Shembull: Çfarë do të ndodhte nëse dielli nuk do të nxehte për një vit ?
(zbatimi i parimit të rëndësisë së diellit për jetë)

Shembull: Sa largë është Prishtina nga Londra në vijë ajrore ?
(parimi i përdorimit të hartës)

Shembull: **Tetë molla peshojnë sa tre ftonjë apo tetë molla peshojnë sa gjashtë banane. Sa banane peshojn dy ftonjë ?**
(zgjidhje problemi)

Foljet vepruese janë:

Ndrysho, demonstro, zhvillo, modifiko, organizo, opero, përgatit, përdor, lidh.

Shembull. Personi që posedon disa profesione është shembull i një :

- A. Kulture shpirtërore
- B. Kulture materjale
- C. Jokulturore
- D. Nënkulturore

Objektiva e synuar: Zbaton konceptet dhe parimet e kulturës në situata të reja

Rezultat i të nxënëit: Parashikon rezultatet e mundëshme të një veprimi bazuar në konceptin e parimit të kulturës

Shembull. Cila nga format e më poshtme për martesën janë aktualisht në shoqërinë Kosovare:

- A. Martesa e një burri me një grua
- B. Rimartesa e një burri me një gruaje tjetër
- C. Martesa e një gruaje njëkohsisht me dy burra
- D. Rimartesa e një gruaje me një burri tjetër.

Objektiva e synuar: Zbaton konceptet dhe parimet e martesës në situata konkrete.

Rezultat i të nxënëit: Parashikon rezultatet e mundëshme të një veprimi bazuar në konceptin e parimit të martesës.

IV. Analiza:

■ Analiza e elementeve:

identifikimi, klasifikimi, dallimi, kategorizimi, dedukcioni

Objektivat : elementet, hipotezat, konkludimet, qasja, formulimi i synimit, formulimi i fakteve të caktuara, argumentet.

■ Analiza e marrëdhënieve:

analizimi, kontrasti, krahasimi, dallimi, deduksioni

Objektivat: marrëdhëniet, ndërlidhjet, relevanca, temat, provat, argumentet e gabueshme, efektet, qëndrueshmeria.

■ Analiza e parimeve të organizimit:

analizimi, dallimi, deduksioni.

Objektivat: format, temat, qëllimet, pikat e vështrimit, teknikat, bazat, strukturat, aranzhimi, organizimi.

Studimi i elementeve;

Studimi i parimeve

Studimi i elementeve në funksionin e kritereve vetiake;

Studim i marrëdhënieve të caktuara

Studimi i një parimi, ligji apo teorie;

Foljet vepruese:

organizon,
ndan,
renditë,
rradhit,
aranzho,
vendos në sekuencë,
interpretton,
lidhë,
klasifikon,
rregullon,
cakton,
zgjedhë,
interpretton,
konkludon.

Nxënësi jepë përgjigje të shumta dhe origjinale për një situatë.

Këtu ka vlerë cilësia e arsytimeve të ndëryshëme.

Pra është rezultat kompleks i të nxënit ku zhvillohet aftësia e **zberthimit** të një informate në pjesët përbërëse të saja dhe **krahasimi** i tyre me qëllim të nxjerrjes, së **përfundimeve** për informatën

V. Sinteza:

■ Prodhimi i komunikimit unik :

të shkruash, të thuash, të ndërlidhësh, të konstitutosh, të origjinalizosh, të modifikosh, ta dokumentosh

Objektivat: strukturat, temat, projektet, performimet, dizajni, puna, komunikimi, specifikat, kompozicioni.

■ Prodhimi i planit ose operacionet e propozuara:

propozimi, planifikimi, prodhimi, dizajnimi, modifikimi, specifikimi.

Objektivat: planet, objektivat, specifikat, skemat, mënyra e operacioneve, zgjedhjet, kuptimet .

■ ***Derivimi dhe marrëdhëniet abstrakte:***

të prodhosh, të derivosh, të zhvillosh,
të kombinosh, të organizosh, të sintetizosh,
të klasifikosh, të formulosh, të modifikosh.

Objektivat direkte:

fenomeni, taksonomia, koncepti, skemat,
teoritë, abstraksionet, përgjithësimet, hipotezat,
perceptimet, mënyrat, zbulimet .

Objektivat që dalin:

- Njohja e informatave relevante, dhe jo relevante;
- Dallimi ndërmjet faktit dhe mendimit;
- Zbatimi i parimeve në zgjidhjen e problemeve;
- Interpretimi i materialit ilustrues;
- Aftësia e njohjes së supozimit;
- Nxjerrja e konkluzionit;
- Përdorimi i vlerave vetjake;
- Plani i veprimit;
- Prodhimi vetjak;
- Prodhimi origjinal;

Foljet vepruese:

kombino, integro, modifiko, korigjo, zëvendëso, planifiko, krijo, konstrukto, parashiko, zbulo, çfarë, nëse, harto, formulo, përgatitë, gjeneralizo, etj.

Kërkesat e analizës janë të nivelit të lartë.

Kërkojnë nga nxënësit shkathtësitë e mendimit kritik;

Vlerësohen dy lloj aftësish:

Zbërthimi i diçkafit në pjesë përbërëse.

Kërkim i lidhjeve ndërmjet dy apo më shumë gjërave.

Shembull. Cili nga pohimet është i saktë që të plotësohen kushtesh për funksionin $y = ax + b$ që ky të jetë negativ.

- A. Duhet që jetë $a > 0$ dhe $b > 0$.
- B. Funksioni y nuk varet nga x .
- C. Duhet që të jetë $a < 0$ dhe $b = 0$.
- D. Funksioni y varet prej x .

Shembull. Si mundë t`a bëjmë shkollën tonë një shkollë efektive:

- A. Duke e pastruar vet nxënësit, dhe ambient të mirë.
- B. Duke pastruar vet nxënësit dhe duke zgjedhë nxënësit të mirë.
- C. Duke krijuar ambient, mësues të përgatitur, programe të mira.
- D. Duke pastruar vet nxënësit dhe programe të mira.

Shembull. Keni vizituar tri ekspozita:

1. ...
2. ...
3. ...

Në cilin rast është paraqitura më së miri pikpamja hapsinore (ose koloriti)

- A. vetëm në 1
- B. vetëm në 2
- C. 1 dhe 3
- D. 2 dhe 3

Tregim:

Në fshatin e lindjes si djalosh i vogël mendoja se dielli lindëte kur këndonte gjeli, atëherë, kënga e gjelit shkaktonte lindjen e diellit

Cili pohim është i drejtë?

A. Kënga e gjelit është shkaktar e lindjes së diellit.

B. Dielli lind atëherë kur dëgjohej kënga e gjelit.

C. Dielli lind pavarësisht nga kënga e gjelit. *

D. Kënga e gjelit është e kohë paskohshme.

A është i drejtë përfundimi se kënga e gjelit është shkak për lindjen e diellit ?

Pra duhet analizuar lidhjen ndërmjet këngës së gjelit dhe lindjes së diellit.

VI. Vlerësimi:

- **Gjykimi në kuptimin e provave të brendshme (anët e forta dhe të dobëta)**

të gjykosh, të diskutosh, të vlerësosh, të vendosësh

Objektivat: *saktësia, qëndrueshmëritë, gabimet, preciziteti*

- **Gjykimet në kuptimin e kriterit të brendshëm dhe kriterit të jashtëm (shkalla e arritëshmërisë).**

të konsiderosh, të krahasosh, të standardizosh, të çmosh

Objektivat: përfundimet, efikasiteti, dobia, teoritë përgjithësimet, kurset e veprimit, standardet.

Çka është e veqana te vlerësimi:

Krahason, dhe dallon idetë

Vlerëson vlerën e teorisë;

Vlerësimi i sistemeve;

Vlerësimi i marrëdhënieve;

Prezanton, prodhon llojllojshmërinë;

Zgjedhja e bazuar në gjykime dhe argumente;

Verifikon vlerat nga evidenca;

Miraton subjektivizimin.

Foljet vepruese:

Vlerëso, vendos, rradhitë, klasifiko, testo, mat, rekomando, bind, përzgjedh, gjyko, interpreto, diskuto, diskrimino-ndaj, mbështet, konkludo, krahaso, përmbledh etj.

Nxënësi, para një situate të re duhet të gjejë një zgjidhje që i përgjigjet kërkesave të përcaktuara mire.

Kush ishte prijësi më i shquar i ilirëve ?

- A.
- B.
- C.
- D.

Nxënsit duhet vendosur disa kriterë për të nxjerrë gjykim saktësinë
(luftar i madhë, fetar i devollshëm, i menqur, ndihmonte popullin etj)

Shembull. Cili ishte personazhi më i preferuar në romanin “”

Shembull. Jeta më e mirë është:

- A. Në qendër të qytetit.
- B. Në periferi të qytetit.
- C. Në fshat malor.
- D. Në fshatra luginor.

Analizë – Zbërthimi i informacionit në pjesë.

- Çfarë ndikuan shkrimet e Ismail Kadares për kohën e ... ?
- Pse u zgjodh kryetar ... ?
- Në bazë të eksperimentit të bërë keni arritur që ...


Sinteza – Kombinimi i ideve që i kemi të ditura për krijimin e ideve të reja.

- Cili është emërtimi i mirë për këtë ... ?
- Si mund t'i përdorët projekti që ...
- Çfarë masash janë ...

Vlerësimi – Krijimi i kriterëve se ku bazohen gjykimet.

- Cili nga ekipet e kanë qenë më të suksesshëm gjatë ... ?
- Cila nga pikturat është më e ... që ju po e ... ?
- Pse po favorizohet më shumë ... ?.


1. Janë paraqitur tri figura të formuar prej trekëndshave.



Plotëso tabelën duke paraqit vetëm numrin e trekëndshave të vegjël që formohen

Figura	Numri i trekëndshave
1	1
2	4
3	9
4	


1. Janë paraqitur tri figura të formuar prej trekëndshave.



Plotëso tabelën duke paraqit vetëm numrin e trekëndshave të vegjël që formohen

Figura	Numri i trekëndshave
1	1
2	4
3	9
...	...
9	

1. Janë paraqitur tri figura të formuar prej trekëndshave.



Plotëso tabelën duke paraqit vetëm numrin e trekëndshave të vegjël që formohen

Figura	Numri i trekëndshave
1	1
2	4
3	9
...	...
n	